



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA PËRGJITHSHME KULTURËS DHE SPORTIT
DREJTORIA E KULTURËS

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2026

Lënda: Kthim përgjigje

E nderuar

Në vijim të kërkesës Tuaj, datë 11.05.2026, Ju sqarojmë që Bashkia Shkoder përmes informacionit të publikuar në faqen zyrtare web garanton transparencën institucionale dhe aksesin publik në informacionin publik për veprimtarinë e institucionit.

Përkatësisht buxhetet vjetore dhe raportet përkatëse të monitorimit për programin buxhetor të kulturës, janë të gjitha të aksesueshme në faqen zyrtare web, ku do të gjeni informacion të detajuar mbi të dhënat që ju kërkon në lidhje me fondet publike të akorduara në fushën e kulturës, numrin dhe llojin e aktiviteteve dhe projekteve kulturore të mbështetura, si dhe numrin e përfituesve dhe indikatorë të tjerë që mund të jenë në interesin tuaj, për periudhën kohore 2020-2025.

Ky informacion është lehtësisht i aksesueshem në faqen web, në rubrikat përkatëse:

- Buxheti ndërmjet vite
- Raporte Monitorimi të zbatimit të buxhetit sipas programeve buxhetore përkatëse
- Programi i Transparencës
- Vendime të këshillit bashkiak
- Vendime dhe Urdhëra
- Këshillim me publikun

Buxheti për programin buxhetor në fushën e kulturës për periudhën 2020-2025:

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/trashegimia_kulturore_eventet_artistike_dhe_kulturore_2894_3171.pdf

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/08220_3529.pdf

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/8220_4608.pdf

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Programi.-08220.pdf>;

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/16.-Programi-8220-PBA-2024-2026_.pdf

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/6.-AF-REelacioni-Sporti-Kultura-pas-komisioneve-23.01.2025.pdf>

Raporte Monitorimi te realizimit te buxhetit per periudhen 2020-2025

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/vkb_nr_33_dt_3_6_21_4125.pdf

https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/relacion_monitorimit_te_buxhetit_2021_4891.pdf

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Relacion-Monitorimi-12-M-2022.pdf>

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Permbledhes-relacioni-Monitorimi-12-Mujori-2023.pdf>

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/VKB-46-25.06.2025.pdf>

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Relacioni-permbledhes-Programe-Monitorimi-12-M-2025.pdf>

Numri i punonjësve të angazhuar në strukturat përgjegjëse për kulturën në bashki për periudhën 2020-2025 është pjesë e indikatorëve të realizimi të buxhetit vjetor perkates dhe e gjeni në linqet mësipër.

Sipas [Vendim nr. 445](#), datë 31/12/2025 “Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të Administratës dhe të Institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër”. (<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Vendim-nr.445-date-31.12.2025-.pdf>), është 55 punonjës, të cilët mbulojnë funksionet në strukturat përgjegjëse për kulturën, që janë: Biblioteka “Marin Barleti me 6 punonjës, Qendra Kulturore “Pjeter Gaci” me 4 punonjës, Muzeu Historik me 4 punonjës, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës me 3 punonjës, Galeria e Arteve me 3 punonjës, Teatri Migjeni me 26 punonjës, Kinema Republika me 4 punonjës dhe punonjës të Drejtorisë së Kulturës, pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit, ku janë 4 punonjës.

Gjithashtu në linqet mësipër mund të aksesoni dhe informacionin në lidhje me fondet e përdorura për restaurime dhe mirëmbajtje të aseteve të bashkisë ku ushtrojnë funksionin institucione si Biblioteka Publike “Marin Barleti, muzeu historik, Vendi I Dëshmise dhe Kujteses”, Galeria e Arteve, Teatri “Migjeni”etj.

Sa i takon restaurimit apo ndërhyrje në objekte të trashëgimisë kulturore, kjo është një përgjegjësi e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, ku mund të kërkonti një informacion më të detajuar.

Konsultimi i buxhetit të bashkisë për çdo program buxhetor është një objektiv i rëndësishëm i Bashkisë Shkodër, i cili synon përfshirjen e shoqërisë civile, komunitetit, bizneseve dhe grupeve të tjera të interesuara. Ky proces ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe të mundësojë që vendimmarrja dhe alokimi i burimeve publike të pasqyrojnë nevojat dhe prioritetet reale të qytetit.

Ky proces realizohet në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftim dhe Konsultim Publik”. Konkretisht janë ndjekur të gjithë hapat ligjor sipas ligjit për Konsultimin me Publikun. I gjithë informacioni është lehtësisht i aksesueshëm në faqen ëeb të Bashkisë Shkodër, në rubrikën Këshillim me Publikun.

Duke ju falenderuar, mbetemi në dispozicion për më shumë informacion apo sqarime të mëtejshme.

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci

ME VENDIM DELEGIMI

Zv/Kryetar

Alban Preka